



**Rëpublika ë Kosovës**  
**Rëpublika Kosova-Rëpublic of Kosovo**  
**Qëvëria -Vlada-Govërmënt**

**Ministræ Shëndetsisë - Ministarstoa Zdravstoa - Ministry of Health**

---

**Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm - Ured Generalnog Sekretara -Office of the General Secretary**  
**Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore - Jedinica za upravljanje ljudskim resursima**  
**Human Resources Management Unit**

Vendi: Prishtinë

Datë: 05.02.2025

Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Shëndetësisë, në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë neni 48 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 dhe paragrafi 6, si dhe duke u bazuar në paragrafin 2 nën paragrafi 2.3, paragrafit 3 dhe 4 të nenit 23 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, më datë 05.02.2025 publikon këtë:

**THIRRJE PUBLIKE**

***Për një (1) Ekspert të jashtëm për anëtar të Komisionit të Pranimit për Kategorinë e Lartë Drejtuese***

1. Kandidatët për Ekspert të jashtëm të Komisionit të Pranimit për kategorinë e Lartë Drejtuese, në pajtim me dispozitat ligjore për procedurën e pranimit në shërbimin civil, duhet që t'i plotësojnë kriterët si në vijim:

- Të kenë Diplomë Universitare, me të paktën 240 kredi;
- Të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale, prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
- Të mos kenë qënë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

2. Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentet si në vijim:

- *Biografinë (CV-në);*
- *Dëshminë e kualifikimit profesional (Diplomën e Universitare). Për diplomat e pramuara jashtë vendit duhet të bashkëngjitet Nostrifikimi i Diplomës;*

- Dëshmitë për përvojën profesionale dhe përvojën menaxheriale, në pozitat e nivelit drejtues;
- Deklaratën me shkrim, që nuk ka qenë anëtar i organeve drejtuese të ndonjë partie politike, të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Certifikatën e gjendjes penale, të lëshuar nga Gjykata kompetente, jo më të vjetër se gjashtë (6) muaj;
- Deklaratën me shkrim që nuk është i punësuar në shërbimin civil, që nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe që nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- Kopjen e letërnjoftimit ose të pasaportës (me afat të vlefshëm me rastin e aplikimit).

Kandidatët për Ekspert të Jashtëm, për kategorinë e lartë drejtuese si personalitet i pavarur në Komisionin e Pranimit për kategorinë e lartë drejtuese, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) euro për një procedurë të rekrutimit, në pajtim me dispozitat e nenit 23 paragrafit 4 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurat e Pranimit në Shërbimin Civil.

Afati për dorëzimin e CV-së, dhe dokumenteve përcjellëse sipas pikës 1 dhe 2 të kësaj thirrje publike, është i hapur nga data: 06.02.2025 deri me 12.02.2025, shtatë (7) ditë.

Mandati i ekspertit të jashtëm është vetëm për një (1) procedurë të rekrutimit të kategorisë së lartë drejtuese.

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta.

Kandidatët e interesuar për aplikim, dokumentet e bashkëngjitura mund t'i dërgojnë përmes postës elektronike në email adresën: [msh.info@rks-gov.net](mailto:msh.info@rks-gov.net)

Për informata shtesë mund të kontaktoni në nr. tel: 038 200 24 073